



**REFLEKTIMI I VLERAVE
SUFISTE-BEKTASHIANE NË POEZINË E
NAIMIT**

Metin Izeti

Njeriu, krijesa më e përsosur në sipërfaqe të tokës, është një tërësi e përbërë nga trupi dhe shpirti. Ky shpirt dhe krijimtaria e lartë e dallojnë atë nga gjallesat tjera të kësaj bote. Trupi i tij pas vdekjes për një kohë të caktuar shkatërrohet, ndërsa shpirti mbetet i përhershëm. Lumturia dhe qetësia e njeriut në këtë dhe botën tjetër në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të varura nga harmonia ndërmjet materies dhe kuptimit, gjegjësisht idesë dhe formës në të. Në momentet kur në jetën e njeriut forcat materiale si lakmia e tepërt, kryelartësia, egoizmi etj., dalin në plan të parë dhe fillojnë ta udhëheqin njeriun, atëherë kuptohet se kjo harmoni ka filluar ta humbë baraspeshën e vet. Pikërisht për këtë është e domosdoshme që shpirti të furnizohet dhe të mos shtyhet në relacionet e tij me elementet materiale.

Mundi dhe përpjekja e njeriut që t'i mbajë të gjallë shpirtin dhe zemrën me një fjalë kuptimin e tij, kanë marrë formën e tyre gjatë historisë dhe janë emërtuar si misticizëm (tesavvuf)

Sikur që njeriu ka anën e tij të brendshme (ezoterike) dhe të jashtme (ekzoterike), po ashtu edhe feja e cila ka për qëllim harmoninë dhe qetësinë e kësaj krijese të përsosur, në kodeksin e saj përmban momente që i takojnë anës së jashtme të njeriut gjegjësisht jetës së tij shoqërore, por ka edhe momente të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me shpirtin dhe kuptimin njerëzor.

Tesavvufi si disiplinë dhe mënyrë e jetës nëpërmjet përfaqësuesve të ndryshëm gjatë historisë ka prezentuar thelbin dhe shpirtin e fesë, ose me fjalë të tjera, është munduar të gjejë përgjigje në pyetjet dhe labirintet e shpirtit njerëzor.

Botëkuptimi sufist që nga ditët e para të Islamit është shpërndarë në të gjitha anët e botës islame. Pothuajse në të gjitha viset e banuara me muslimanë, në arkitekturën sakrale krahas xhamive dhe medreseve shohim edhe ekzistencën e teqeve, të cilat në formë të treshit të artë kanë kontribuar në prezentimin e vlerave hyjnore në popullatën e viseve gjegjëse. Por, krahas asaj, edhe në paraqitjen dhe zhvillimin e arteve dhe artizanateve.

Tesavvufi në fillim paraqitet si reagim i personaliteteve të dalluara të shoqërisë së Pejgamberit a.s. kundër luksit dhe padrejtësive, të cilat fillojnë të ngrenë kokën në periudhën e pushtetit emevit, ndërsa më vonë merr formën e aksionit dhe ndikimi i tij është i dukshëm në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Periodha ndërmjet shekujve VI-XII është periudhë e sistematizimit të mendimeve të ndryshme sufiste rreth një tarikati (drejtimi) të veçantë. Botëkuptimet individuale sufiste të kultivuara nga ana e sufive të mëdhenj si Xhunejd Bagdadi, Ebu Jezid Bistami, Imam Gazaliu, pas kësaj kohe u sistematizuan dhe institucionalizuan në tarikatat. Periodha e tarikatit filloi në shekullin XII dhe vazhdoi deri në ditët e sotme. Shekulli XII është koha e dobësimit të përgjithshëm të shtetit abasid dhe e depërtimit mongol nga Lindja. Shtetet e vogla të formuara brenda kufijve të shtetit abasid nuk kishin mundësi që t'i kundërvihen pushtuesit të fuqishëm mongol, prandaj popullata kryesisht u tubua rreth liderëve shpirtërorë - sufive.

Sufitë e dalluar të asaj kohe si Abdu'l-Kadir Gejlani (420\1026), Ahmet Rifai (578\1183), Ahmed Jesevi (562\1166), Ibn Arebi (638\1240), Mevlana Xhelaluddin Rumi (628\1231) formuan tarikate të veçanta, të cilat jetën e tyre e vazhduan deri në ditët e sotme.

Në gjysmën e dytë të shekullit XII në Anadoll u shkaktuan trazira të mëdha. Autoriteti politik i shtetit abasid ishte luhatur në tërësi ndërsa sulltani i Selxhukëve, Këllëçaslani II kishte vështirësi të mëdha në mbrojtjen e kufijve të shtetit të madh të lulëzuar në kohën e gjyshit të tij Alaeddin Kejkubadit. Në Lindje mongolët ishin në

përgatitje e sipër për t'i sulmuar vendet islame. Në këtë periudhë mjaftë të vështirë kur bota islame përjetonte krizë të thellë pothuajse në të gjitha sferat e jetës si në atë politike, ushtarake e shoqërore, një numër i madh i dijetarëve e posaçërisht i sufive u vendosën në Anadoll. Në këto kohë kur sistemi shoqëror ishte shkatërruar në tërësi, masa e gjerë popullore të vetmin shpëtim e gjeti në mbështetjen në liderët shpirtërorë të ardhur në Anadoll nga vise të ndryshme të botës islame.

Sufitë dhe shejhët e ardhur nga vende të ndryshme kryesisht u vendosën në qytetet e mëdha të Anadollit, ku dhe i ngritën teqetë e tyre.

Përderisa në qytetet dhe qendrat e mëdha gjendja ishte e këtillë, jeta fetare gjegjësisht tesavvufi në viset malore e periferike, banorë të cilëve kryesisht ishin turkmenët, udhëhiqej nga ana e shejhëve dhe baballarëve të cilët shumë pak e njihnin Islamin e të mos flasim për tesavvufin. Në këto vise ende nuk ishin çrrënjësuar definitivisht botëkuptimet e vjetra pagane dhe dalëngadalë fillonin të konsiderohen si elemente të fesë së re të pranuar. Ky moment dukshëm do të ndikojë në konstruktin e mëvonshëm të një pjese të tarikateve të vendosura në viset periferike të Anadollit si te kalenderinjtë, babainjtë, hajdarinjtë e në masë më të vogël edhe te bektashinjtë.

Në kohën kur nga njëra anë me të madhe depërtonin idetë e devijuara të batinive (ezoteristëve) e nga ana tjetër popullata periferike kishte mbetur në duart e shejhëve dhe baballarëve të paafte, nga Horasani në Anadoll erdhi Haxhi Bektash Veliu i cili me një metodë tolerante dhe sintetizuese u mundua që këto grupe të njerëzve t'i mbajë nën ombrellën e Islamit.

Haxhi Bektash Veliu ishte një Pir i madh, njohës bukur i mirë i mendimit sufist islam, por në të njëjtën kohë edhe njohës shumë i mirë i rrethanave kohore në të cilat jetoi. Veprimtaria dhe mendimet e Haxhi Bektash Velit tregojnë qartë se ka qenë musliman, i rritur dhe i edukuar në frymën e kulturës sufiste islame, i shoqëruar me liderët sufistë të asaj kohe si me Mevlana Xhelaluddin Rumin, Sadreddin Koneviun, Evhaduddin Kirmanin. Aktiviteti i tij i përgjithshëm ka qenë i orientuar kundër propagandës batinijje (ezoteriste) të thirrësve të shtetit safevid. Duke u bazuar në disa praktika më liberale dhe tolerante të bektashinjeve të mëvonshëm, një grup i dijetarëve nën ndikimin edhe të disa orientalistëve, bektashinjtë do t'i emërtojnë si tarikat heterodoks, kurse grupi tjetër do t'i quajë tarikat i dalë jashtë binarëve të Islamit, madje një grup tejet ekstrem do të orvatet që tarikatit bektashian ta konsiderojë si fe të veçantë.

Asnjëri nga vlerësimet e lartpërmendura nuk pajtohet aspak me argumentet historike dhe bibliografike të paraqitjes dhe zhvillimit të tarikatit bektashian.

Pikësëpari përdorimi i termit heterodoks, i cili në Perëndim përdoret si antitezë e termit ortodoks është i gabuar, për arsye se këta dy terma janë terma krishterë dhe në terminologjinë e Historisë së Fraksioneve kanë këtë kuptim:

- **ortodoks** - grup fetar i cili jetën fetare e rregullon sipas botëkuptimit zyrtar të kishës.

- **heterodoks** - grup fetar i cili në praktikën fetare del jashtë vijës kishtare.

Përdorimi i këtyre termave për Islamin në të cilin nuk ka një rregullim dhe botëkuptim zyrtar të praktikës fetare, që në fillim është i gabuar. Prandaj, nëse në mesin e muslimanëve paraqiten momente dhe nuanca të ndryshme dhe ato nuk dalin jashtë Kur'anit, sipas vlerësimit të Pejgamberit a.s. janë rahmet (mëshirë).

Gjithashtu edhe vlerësimi i cili bëhet nga ana e dijetarëve tradicionalistë muslimanë se bektashinjtë janë tarikat joislam, është ekstrem dhe i papërshtatshëm me sistemin e vlerave në Islam. Pejgamberi a.s. nuk lejoi që askujt t'i themi pabesimtar, kurse prej

nesh kërkoi të bëjmë përpjekje që njerëzve të cilët bëjnë devijime në praktikën fetare, me sjelljet dhe mendimet tona përparimtare, tërheqëse dhe të matura t'ua ofrojmë rrugën e vërtetë.

Kurse sa i përket mendimit se tarikati bektashian është një fe e veçantë, mendoj se ky është një gabim trashanik i cili nuk mund të argumentohet me kurrfarë fakte, as historike, as bibliografike e as apologetike.

Tarikati bektashian dhe themeluesi i tij Haxhi Bektash Veliu janë një hallkë e zinxhirit të tesavvufit islam. Veprimtaria e tyre disashekullore ka qenë e orientuar në përhapjen dhe kultivimin e vlerave islame dhe askush nuk ka të drejtë që si bektashi veten ta konsiderojë jashtë Islamit, e as që ka të drejtë që bektashinjtë, për këtë ose atë, t'u thotë se nuk janë muslimanë.

Siç thamë edhe më lartë, tesavvufi përveç rolit të tij në përhapjen e Islamit dhe qetësimin e zemrave të njerëzve, rol të veçantë pati edhe në kultivimin e vlerave artistike në mjedise të ndryshme. Shembujt e këtillë janë të shumtë, mirëpo që të mos zgjerohemi tepër do të përqëndrohemi në prezentimin e këtyre vlerave të Idesë së Lartë në poezinë e penës madhështore të letërsisë shqiptare, Naim Frashërin, duke i krahasuar ato me poezitë e poetëve sufistë të inspiruar nga i njëjti burim si edhe Naimi.

Naimi u lind në Frashër më 25 maj të vitit 1846. Që nga mosha fëmijërore filloi t'i ndjekë mësimet në teqenë e Frashërit dhe këto mësimet së bashku me origjinalitetin e shprehjes së Naimit, do të jenë pasqyrë bazë në prezentimin e gjithanshmërisë së tij.

Naimi mendimet, qëndrimet dhe botëkuptimet ndaj ngjarjeve dhe çështjeve të ndryshme historike-shoqërore, në veprën e tij i trajton në pajtim me filozofinë e vet sufiste islame.

Prezentimi i çështjeve shoqërore, historike e patriotike brenda fushëveprimit të vetëdijes fetare është rezultat i vetëdijes së tij, pasi ajo ishte e vendosur mbi një korelacion të drejtë e pozitiv, siç shihet në poezinë e Naimit, mes vetëdijes shoqërore, historike, patriotike dhe fetare tek ai.

Prej veprës së tij mund të shihet qartë se Naim Frashëri është një figurë e gjithanshme dhe e rëndësishme në letërsinë, kulturën dhe në historinë e përgjithshme të popullit shqiptar. Ai pa dyshim është njëri ndër shkrimtarët më të mëdhenj të letërsisë shqiptare.

Të gjitha aspektet e jetës dhe veprës së Naimit në këtë ose atë mënyrë janë studiuar dhe trajtuar, mirëpo njëra nga karakteristikat dalluese në aktivitetin jetësor dhe poetik të Naimit, në etikën dhe mendimin e tij, karakteri sufist islam, gjithnjë mbeti nën hije. Nuk ka kurrfarë arsye që kjo vetëdije e lartë e Naimit, e lartë po aq sa edhe e Xhelaluddin Rumi, Hafizit, Shejh Sadit, Gëtes, Master Ekhartit etj., të minimizohet ose të zhvlerësohet qëllimisht.

Naimi është njohës bukur i mirë i tesavvufit islam e posaçërisht i Tarikatit bektashian. Ai shumë bukur e njihte poezinë klasike sufiste, hollësitë e saj, e krahas kësaj edhe të gjitha hollësitë e retorikës. Në poezinë e tij në formë tepër tërheqëse janë vendosur vargjet e larta shpirtërore, ku në formë simbolike e ku të drejtpërdrejtë.

Naimi në veprën e tij shpeshherë e thekson fjalën dhe relacionin e saj me realitetin i cili qëndron i fshehur pas saj. Ai njëkohësisht bën përpjekje që këtë relacion mes fjalës dhe realitetit të saj ta zgjidhë dhe ta prezentojë sa më mirë. Nuk ka dyshim se Naimi këtë zgjidhje e ka gjetur, poezia e tij është tepër e logjikshme për shkak se ai është poet i cili i mbeti besnik thelbit, dashurisë dhe botëkuptimit të vet dhe të gjitha këto ngjarje i ka kahëzuar dhe formuluar sipas ligjit të tij të brendshëm.

Duke e marrë parasysh këtë realitet, do të mundohem të prezantoj disa çështje me rëndësi në poezinë e Naimit.

Vahdeti (Njësimi) në Poezinë e Naimit

Njohja e Zotit si një ekzistencë e vetme absolute nga të gjitha aspektet dhe prizmat, në tesavvufin islam emërtohet si Vahdet. Në botëkuptimin sufist ekzistenca absolute i takon vetëm Allahut xh.sh., kurse gjërat tjera janë relative, gjegjësisht ekzistenca e tyre prezenton Hakikatin (realitetin) Hyjnor.

Çështja e Vahdetit është diskutuar pothuajse nga të gjithë poetët sufij në letërsinë klasike islame. Sipas tyre, ekzistenca e Allahut i ka përfshirë të gjitha dukuritë ekzistuese në të gjitha shkallëzimet ontologjike të tyre. Ekzistenca e Tij është e pranishme në hakikatin (realitetin) e të gjitha sendeve që përkapen në gjithësi.

Poeti i madh klasik Rumi, në një dyvargësh thotë kështu:

"Xhame ez ten xhan zi ten agah nist

Der dimagesh xhuz gam-I Allah nist"

"As teshat prej trupit e as trupi prej teshave s'është larg

Në trurin e tij nuk ka gjë tjetër pos brengës për Zotin".

Nijazi Misriu në një dyvargësh të vetin thotë:

"Oyle sanirdim ayriyim dost gayridir ben gayriyim

Bende olup ishiteni bildim ki ol canan imish".

"Mendoja që unë jam i ndarë, i Dashuri im veç e unë veç

Mirëpo kuptova që çdo gjë në mua qenka ai i Dashuri".

Edhe Naimi në poezinë e tij në shumë momente e paraqet këtë të vërtetë. Ai thotë:

"Zoti i vërtetë ty të besojmë

Të gjitha ç'janë dhe të lëvdojnë

Qiej edhe yj e dhe e hënë

Urdhërove the dhe u bënë

Çdo gjë që është tynë të tregon

Dhe çdo e mirë prej teje buron

Falna Zot i madh ne njerëzinë

Edhe të mirat e dashurinë

Përveç se një e vërtetë

Gjësendi s'ka nder në jetë".

"Posi kosa që korr barë

Dhe mbin farë-farë

Më çdo vënt të gjithësisë

Duket fuqi e Perëndisë

Mendjemadh e shpirt i gjerë,

Drit' edhe gjallj' e pa prerë!

Gjithësia 'sht ajy vetë

Zot i madh e i vërtetë".

Siç shihet edhe nga vargjet e prezentuara, të cilat janë vetëm një pikë në detin e literaturës sufiste të shkruar në këtë temë, inspirimi i dy poetëve të sipërpërmendura të cilët u takojnë dy qytetërimeve të larta botërore, ku rol të veçantë luajti tesavvufi si disiplinë, dhe inspirimi i poetit tonë, janë nga burimi i njëjtë. Vargjet e tyre rrjedhin nga vendi i njëjtë në brendinë e njeriut.

Për Naimin Zoti, siç e shprehë edhe Kur'ani, është Krijues dhe Planifikues i ekzistencës, Ai është mëshirëplotë dhe mëshirëbërës. Bota, gjegjësisht gjithësia, është pasqyrë e prezentimit të bukurisë (xhemalit) të Allahut xh.sh. Zoti nuk është vetëm arkë e bukurisë por edhe e mirësisë.

Naimi në poezinë e tij problematikën mjaft të koklavitur filozofike të ekzistencës absolute me një gjuhë të rëndomtë të bazuar në inspirimin e tij sufist, e prezenton me simbolet dhe shembujt e jetës dhe realitetit kohor të vet. Sekretet e lartësisë dhe freskisë në poezinë e Naimit fshehet në këtë poentë të tij.

Njeriu në poezinë e Naimit

Njeriu me ndërtimin shpirtëror dhe material të tij, konsiderohet si krijesa më e përsosur në gjithësi. Pikërisht për këtë njeriu është bërë objekt rreth të cilit janë trajtuar ide të shumta që nga fillimi i vetë ekzistencës. Edhe Naimi në poezinë e tij vend të posaçëm i kushton njeriut, për të cilin thotë se është krijesë në të cilën bashkohen mendja dhe shpirti.

Përderisa në idetë e ndryshme filozofike në histori njëra palë i ka kushtuar rëndësi të veçantë shpirtit kurse pala tjetër materies gjegjësisht arsyes, Naimi njeriun e sheh si një tërësi të përbërë nga forma dhe ideja, trupi dhe shpirti, respektivisht ai paraqet tërësi të dy vlerave të ekzistencës - materies dhe shpirtit. Sipas tij kultivimi i përbashkët i fizikës dhe metafizikës, mendjes dhe shpirtit e vendosë këtë krijesë të përsosur në vendin e merituar .

Ja çka thotë Naimi:

Zot' i Madh e i Vërtetë

Nemërit e me urdhërit të Zotit të math e të vërtetë!

Zot i gjithësisë dhemje-math e mëshirë shumë!

Falna urtësitë e mirësitë e mërgona nga të këqijat e nga të pa-udhëtë.

Dashuri i Zotit është krej' i urtisë. Ata që duanë Zotnë, kërkojnë të vërtetnë, e mërgojnë të rremenë, qasinë mirësinë e përzënë djallëzinë, dëbojnë armikun e mbajnë miqësinë e vëllazërinë.

Qëroni zemrënë dhe mendjen e vetëdienë edhe shpirtinë nga gjithë fëlliqjet e ligësivet, pa zini ngoje Zotn e math e të vërtetë".

Çështja e krijesës më të përsosur, njeriut, në mënyrë identike me Naimin është përpunuar edhe në poezitë e sufijve tjerë të mirënjohur. Në poezinë e Runit njeriu prezentohet si sintezë e shpirtit dhe mendjes. Ai është krijesa që pranoi amanetin (fenë) e Allahut xh.sh . Mevlana thotë kështu:

"Kontrollo mirë damarët e zemrës dhe besimit

Që të shohësh je i mirë ose i keq

Analizo mirë urinën në kavanoz, shiko mirë

Do të shohësh rezultatin e veprave tua

Mevlana Rumi pos ndjenjave materiale të njeriut gjithmonë e ka parasyshtë sferën tjetër, e cila e lartëson njeriun drejt realiteteve të larta. Në momentin kur njeriu i ngre perdet, atëherë humben dallimet e kësaj bote të inicuar nga materia dhe paraqitet njësimi.

Në një dyvargësh Mevlana thotë:

"Deri kur do të shikosh formën time

Mos harro se pas drurit të manit ka mëndafsh të bukur".

Shihet qartë se në poezinë e Naimit si dhe në poezitë e sufijve tjerë para tij, njeriu ka një kuptim dhe rëndësi kozmologjike. Ai është krijesa e vetme në të cilën është sendërtuar vullneti kreativ brenda kohës dhe vendit. Zoti i Madh atij i ka fryrë prej shpirtit të Vet. Atë e ka furnizuar me intelekt, arsye, shpirt etj., që të mund t'i përkapë dhe t'i zbulojë fshehtësitë e kohës në të cilën jeton.

Ky inspirim i poetëve tanë drejtpërdrejt është marrë nga Kur'ani i Lartë. Kur'ani flet për të dy mënyrat e krijimit të njeriut: ***"Njeriu u krijua prej dheut dhe në të u fry prej Shpirtit të Allahut"***.

Gjegjësisht Naimi për ta realizuar humanizmin e vërtetë rekomandon një gjithësi teocentrike në vend të kozmosit egocentrik, rekomandon një humanizëm teonom në vend të njerëzshmërisë autonome, respektivisht prezenton një humanizëm teist, epiqendër e të cilit do të ishte Allahu xh.sh.

Dashuria e Lartë Hyjnore në poezinë e Naimit

Karakteristikë e cila haset shpesh në poezinë e Naimit është edhe dashuria e lartë ndaj Fuqisë absolute krijuese, respektivisht ndaj Zotit të Madhërishëm.

Në poemën e tij të shkruar në gjuhën greke "O Eros" (Dashuria), në mënyrë klerkë është prezentuar shkallëzimi i ekzistencës dhe afrimi fundor ndaj saj shfaqet në formën e dashurisë.

Arsyeja ka mundësi që t'i sqarojë dhe komentojë objektet e reflektuara të Ekzistencës absolute, ndërsa kontakti me Qenien absolute mund të bëhet vetëm nëpërmjet dashurisë. Thelbi i ekzistencës nuk është objekt i arsyes, por i dashurisë. Naimi në momentet kur e thekson dashurinë nuk e mohon realitetin e arsyes, mirëpo tregon kufirin fundor deri ku ajo mund të ngjitet. Për t'u ngritur në lartësitë e krijimtarisë është e domosdoshme dashuria e lartë. Dashuria është udhërrëfyese besnik drejt sarajeve të estetikës hyjnore, rrëqethjet shpirtërore konsiderohen si thirrje nostalgjike drejt Krijuesit të Lartë.

Në poemën "Dashuria" Naimi pasi i prezenton shkallët e dashurisë, duke filluar prej fizikës, në fund thotë kështu:

"Në qiell, Dashuria

Si shpend nga pas më vjen

Pafundësia, tempull

Kolos më shëmbëllen.

*Dritëza duken yjet
Dhe brenda Perëndia
Krijuesi dhe ati
Nga merr fill gjithësia
Ti je çdo gjë, o Zot
Ti bota e hapësisë
Ti nisja e mbarimi
Ti shpirti i gjithësisë
Dhe dashuria ime
Je vet, o Perëndi
Çdo gjë je ti këtu
Edhe kudo je ti.
As dritë tempulli
As yll që ndrit
Por çdo gjë është
Shkëlqimi yt!
Prej teje nisen
Tek ti mbarojnë
Gjithë sa kemi
Ty të takojnë
Hyjnore, e bukur
Me të vërtetë
Feja e jote
Njerëzimi vetë!
Një shpirt ne jemi
Ndaj Perëndisë
Miq e vëllezër
Ndaj dashurisë
Edhe Xhelaluddin Rumi në "Mesnevi" në mënyrë identike i afrohet kësaj
çështjeje:
"Ti je qumsht, ëmbëlsirë e sheqer
Ti je hënë, e diell që shkëlqen
Ti je babë, e nënë
Përveç Teje nuk kam farefis.
O dashuri që nuk vëshkesh
O këngëtar me hare hyjnore
Nuk gjeta si Ti shok kurrë
Në mbrojtje dhe fuqi.*

Dashuria e lartë ka qenë çështja për të cilën gjatë historisë kanë shkruar qindra poetë sufij. Unë këtu e përmenda vetëm Rumin për shkak se ai në veprën e tij ka bërë një sintezë të poezisë dhe disiplinës së deriatëhershme të tesavvufit dhe njëkohësisht ka shërbyer si shembull për poetët sufij që erdhën pas tij.

Në këtë trajtesë të shkurtër u mundova të paraqes disa momente nga të cilat është inspiruar poeti ynë i madh, Naim Frashëri. Pa dyshim, njëra nga karakteristikat më parësore në veprimtarinë jetësore të Naimit, në botëkuptimin e tij rreth problematikave të ndryshme është aspekti sufist i besimit islam. Prania e momentit fetar, posaçërisht e aspektit sufist-bektashian në veprimtarinë e Naimit, atë nuk e bën më pak patriot ose më

pak intelektual, përkundrazi, e prezenton si një personalitet të ngritur në të dy aspektet e jetës së njeriut, si dhe e afron më tepër me qenien e popullit dhe nënqiellin tonë. Njëkohësisht ndritshmëria e tij materiale-shpirtërore e vendosë atë në hallkën e merituar të zinxhirit të tesavvufit islam, e veçanërisht të tarikatis bektashian.

Prandaj është e domosdoshme që aspekti sufist i poezisë së Naimit të trajtohet pa paragjykime dhe t'i jepet vlera e duhur.

Ai jo vetëm që në mbarë poezinë e tij vend të posaçëm i jep idesë së lartë sufiste, por shkruan edhe një traktat të shkurtër të posaçëm për tarikatit bektashian me titull “Fletore e Bektashinjët”.

Jeta dhe vepra e Naim Frashërit na obligon që atë ta shohim si një poet të madh i cili vend parësor në poezinë e tij i ka kushtuar idesë së lartë, respektivisht aspektit sufist të besimit islam.